



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201400242/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për bashkërendim të punës me njësitë e qeverisjes vendore, që pas identifikimit të familjeve të ngujuara nga gjakmarrja në të gjithë territorin e Shqipërisë, të krijohen mundësitë për aplikim të përfitimit të ndihmës ekonomike.*

Drejtuar: **Z. Erjon Veliaj**
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

TIRANË

I nderuar Zoti Ministër,

Fenomeni i gjakmarrjes vazhdon të mbetet një problem shqetësues për të gjitha familjet shqiptare. Shumë fëmijë të pafajshëm dhe familje të tëra po vuajnë një plagë të shoqërisë shqiptare, që është trashëguar brez pas brezi, deri në ditët e sotme. Çështja e familjeve të ngujuara në të gjithë territorin e Shqipërisë dhe me problemet e shumta dhe të rëndësishme që shqetësojnë këtë komunitet njerëzish, është ndjekur intensivisht nga ana e institucionit tonë, e finalizuar kjo me një "Raport të Posaçëm", drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.

Në kuadrin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit, në Konferencën e organizuar në muajin Dhjetor 2014, një sesion i veçantë ia kushtoi kësaj çështjeje. Në analizë të këtij fenomeni u referuan disa gjetje konkrete si nga shoqatat, ashtu edhe nga aktivistë dhe institucione të ndryshme që diskutuan për këtë fenomen.

Gjakmarrja në Shqipëri ndonëse e lokalizuar në disa zona është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë, sepse cënon të drejtën më të rëndësishme të njeriut, të drejtën e jetës. Mungesa e punësimit, të qenit pa punë, pa të ardhura, pa mirëqënie, i bën të ndjehen të stresuar. Shumë familje vuajnë nga izolimi dhe frika e vdekjes. Shumica e tyre, pasi hyjnë në gjak, fshihen ose ngujohen në shtëpitë tyre dhe si rrjedhojë nuk mund të fitojnë më bukën e gojës. Sa më shumë të zgjasë kjo gjëndje, aq më shumë varfërohen.

Ndërkohë shqetësimin e këtij fenomeni dhe sidomos vitet e fundit po e ndiejnë dhe vuajnë edhe disa vende të BE-së, për shkak të numrit në rritje të azilkërkuesve shqiptar, duke përfshirë edhe ato raste abuzive të personave të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni. Gjakmarrja nuk është vlerësuar seriozisht nga strukturat shtetërore, të cilat fatkeqësisht nuk kanë dëshiruar që ta pranojnë atë.

Këtë qëndrim e tregon edhe fakti që nuk ka statistika të sakta nga policia për numrin e të vrarëve për gjakmarrje, të familjeve dhe të personave të ngjuar, mandje ato nuk administrohen as nga INSTAT-i. Kjo ndodh edhe për faktin se fenomeni është dinamik. Fenomeni është mesjetar, kriminal dhe jo i pastër kanunor.

Familjet e ngjuara janë në gjendje të mjerueshme ekonomike. Problemet sociale të familjeve të ngjuara kërkojnë një angazhim më të madh të shtetit, posaçërisht të Ministrisë që Ju drejtoni, që, nëpërmjet zyrave rajonale, të shkojnë tek familjet e ngjuara për ti dhënë mundësi të aplikojnë për ndihmë ekonomike atyre familjeve me të ardhura të pamjaftueshme me qëllim uljen e nivelit të varfërisë

Sa më sipër, me qëllim që tu sigurohet mundësia e përfitimit të ndihmës ekonomike familjeve të ngjuara nga gjakmarrja, në mbështetje të pikës 3 të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për një bashkërendim të punës me njësitë e qeverisjes vendore, që pas identifikimit të familjeve të ngjuara nga gjakmarrja në të gjithë territorin e Shqipërisë, të krijohen mundësitë për aplikim të përfitimit të ndihmës ekonomike.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin Nr.8600, datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin Nr. 9398, datë 12.05.2005, ku thuhet shprehimisht se: *“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”*,

Lutemi, pas shqyrtimit, të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj

Me respekt

AVOKATI I POPULLIT

IGLI TOTOZANI

